

COOL-LITE® KN 148 II RHAPSODY

KOMFORT I BRENDSHËM DHE ESTETIKË
E JASHTME E SHKËLQYER

COOL-LITE® KN 148 II RHAPSODY

KARAKTERISTIKA DHE PËRFITIME SPECIFIKE:

- I përshtatshëm për projekte të ndryshme
- Efikasitet afatgjatë në terma të konsumit të energjisë
- Eksperiencë e brendshme e shkëlqyer nëpërmjet komfortit termik dhe visual
- Potencial kreativ i lartë, i cili mundëson integrimin në ambiente të ndryshme urbane



SAINT-GOBAIN
CONSTRUCTION
PRODUCTS ALBANIA

Rr. Budull, Nr. 3 • 1039
Ahmetaq, Prezë
Vorë • Albania

Suport Teknik

Mob: +355 69 20 24 002

Mob: +355 67 70 17 770


All image rights © Adobe Stock Photo

BUILDING GLASS





Parku Kombëtar i Liqeneve të Plitvicës (Plitvička jezera), Kroaci
Pjesë e Trashëgimisë Botërore nga UNESCO



Art folklorik, fshati Petrykivka,
Ukrainë
Pjesë e Trashëgimisë Botërore
nga UNESCO



Shkëmbinjtë Belogradchik,
Bullgari
Pjesë e Trashëgimisë Botërore
nga UNESCO



Navagio, Greece - most famous beach of
Zakynthos and Ionian Islands

APLIKIMET

COOL-LITE® KN 148 II RHAPSODY është një produkt shumëpërdorimësh, i përshtatshëm për të gjitha llojet e fasadave në ndërtesa komerciale dhe jo-rezidenciale (si p.sh zyra, dyqane, hotele, restorante etj) dhe ndërtesa banimi tw standarteve tw larta (shtëpi, apartamente, verandat) gjithashtu. Rezultati është vizualisht i kënaqshëm, me një integrim optimal në arkitekturën dhe peizazhin natyral.

Një produkt i ri nga Saint-Gobain, i krijuar ekskluzivisht për klimën në Juglindje të Europës, COOL-LITE® KN 148 II RHAPSODY shpreh një mori ndjenjash të paharrueshme, tingujsh dhe vendesh që krijojnë këtë histori epike të plotë. Rhapsody – shprehja më entuziaste e këtyre elementëve të përmbledhur në një.

Ngjyra elegante e fildishtë dhe përshtatshmëria estetike e bën COOL-LITE® KN 148 II RHAPSODY një premtime të mbajtur për ndërtesat me përzgjedhje të personalizuar, të integruara në mënyrë perfekte në peizazhin modern urban. Brenda, xhami është neutral dhe reflektimi është i ulët, prandaj ngjyrat e jashtme shfaqen në vërtetësinë e tyre.

Në përfitimin e përdoruesve të saj, kjo veshje e re e argjenditë bashkon personalitetin e shquar të jashtëm me komfortin e brendshëm të klasit të lartë. COOL-LITE® KN 148 II RHAPSODY hap rrugën për krijimtarinë arkitektonike, duke u siguruar përdoruesve një mjedis komod si në izolimin termik ashtu dhe në rehatinë vizuale.

COOL-LITE® KN 148 II RHAPSODY përfitohet duke përhapur veshjen e argjenditë me një shtresë xhami të kristaltë PLANICLEAR® nëpërmjet përdorimit të teknologjive më të avancuara.



PROCESIMI I COOL-LITE® KN 148 II

IZOLIMI I NJËSIVE TË XHAMIT

COOL-LITE® KN 148 II RHAPSODY duhet gjithmonë të montohet në IGU, me veshjen në faqen #2

TEMPERIMI

Veshja duhet të temperohet që të arrijë performancën dhe estetikën e kërkuar. EASYPRO® ndihmon për një procesim më të mirë dhe të thjeshtë.

LAMINIMI

Veshja që mund të laminohet është ajo që nuk është në kontakt me membranën PVB.

Shënim: COOL-LITE® KN 148 II RHAPSODY duhet të trajtohet me nxehtësi përpara laminimit.

TESTIMI I PËRTHITHJES SË NXEHTËSISË

Rekomandohet që të bëhet për të gjithë xhamat e temperuar, për të shmangur thyerjet spontane për shkak të përfshirjes së NiS.

PËRKULJA

Xhami COOL-LITE® KN 148 II RHAPSODY mund të përkulet brenda disa limitimeve specifike. Ju lutem kontaktoni Departamentin Teknik.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE COOL-LITE® KN 148 II RHAPSODY

STRUKTURA TË QËNDRUESHME

SHIKUESHMËRI E NJË CILËSIE TË LARTË

- Pamje e jashtme neutrale – pak e fildishtë
- Reflektimi i jashtëm në nivel mesatar, me një qartësi të mirë të ngjyrave
- Reflektim i brendshëm i ulët për më shumë komfort vizual

FAKTORËT NDRIQUES	DGU*	TGU**
Transmetimi i dritës (LT%)	47%	43%
Reflektimi i jashtëm (RLe %)	27%	28%
Reflektimi i brendshëm (RLi %)	18%	20%

* 6/16/4mm me COOL-LITE® KN 148 II në faqen #2, 90% Argon

** 6/16/4/16/4mm me COOL-LITE® KN 148 II në faqen #2 dhe PLANITHERM® XN II në faqen #5, 90% Argonwith



LT/RLe/RLi sipas EN 410

MIKROKLIMË E KËNDSHME

- Humbje e ulët e energjisë gjatë motit të ftohtë
- Reduktim i mbinxehjes gjatë motit të nxehtë
- Shfrytëzim i përshtatshëm i ndërtesës, me kosto të ulët të ngrohjes dhe ftohjes

FAKTORËT DIELLOR	DGU*	TGU**
Faktor diellor (g)	0.32	0.28
Koeficienti i hijëzimit (SC)	0.37	0.32
TRANSMETIMI TERMIK		
Ug W/m²K (0° në lidhje me pozicionin vertikal)	1.0	0.5

* 6/16/4mm me COOL-LITE® KN 148 II në faqen #2, 90% Argon

** 6/16/4/16/4mm me COOL-LITE® KN 148 II në faqen #2 dhe PLANITHERM® XN II në faqen #5, 90% Argon

g sipas EN 410

Ug sipas EN 673

PAMJA

ESTETIKA	
Nga jashtë	Neutrale, pak e fildishtë
Në transmetimi	Neutral



GAMA

PRODUKTI	TRASHËSIA(MM)	DIMENSIONET MAKSIMALE (MM)
COOL-LITE® KN 148 II RHAPSODY	6, 8, 10 with EASYPRO®	6000 X 3210